



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVËS
POLICIJSKI INSPEKTORAT KOSOVA / POLICE INSPECTORATE OF KOSOVO

Hajvali Prishtinë

Nr./Br. 04-052-1684/2

Data / Datum 15.10.2021



**MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME
INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVËS
DEPARTAMENTI I INSPEKTIMEVE**

**RAPORT I INSPEKTIMIT
"KRYERJA E DETYRAVE GJATË TRAJTIMIT POLICOR TË RASTEVE TË
DHUNËS NË FAMILJE"**

Nr. 5/2021

Prishtinë, 14 tetor 2021

Informata të përgjithshme

Titulli	Raport i inspektimit “Kryerja e detyrave gjatë trajtimit policor të rasteve të dhunës në familje”
Data e përgatitjes	14 tetor 2021
Realizuar nga	Xhavit Fetahaj, udhëheqës i ekipit të inspektimit, Fitore Gajraku, inspektor, Servet Tasholli, inspektor, Shqiponjë Sopi, inspektor, Kushtrim Jonuzi, inspektor, Mirsad Puqurica, inspektor, Teuta Rukolli, inspektor
Mbikëqyrur nga	Illir Idrizaj, mbikëqyrës i inspektimit, Udhëheqës i Divizionit të Inspektimit dhe Raportimit
Mbështetur nga	Bujar Mustafa, Udhëheqës i Divizionit për Analizë, Planifikim dhe Cilësi
Dorëzuar nga	Bekim Pira, Udhëheqës i Departamentit të Inspektimit
Miratuar nga	Kushtrim Hodaj, Kryeshef Ekzekutiv, Inspektorati Policor i Kosovës
Data e miratimit	14 tetor 2021



© Të drejtat e autorit të Inspektoratit Policor të Kosovës.

Teksti i këtij dokumenti mund të riprodhohet falas në çdo format ose medium, me kusht që të riprodhohet me saktësi dhe jo në një kontekst ndryshe nga se raportohet këtu.

Ky material duhet të njihet si e drejtë e autorit (IPK) dhe dokumenti si titulli i specifikuar.

Kur është identifikuar materiali nga pala e tretë, leja nga mbajtësi i të drejtës së autorit duhet të kërkohet.

Çdo pyetje në lidhje me këtë publikim duhet të na dërgohet në:

Inspektorati Policor i Kosovës,
Rruga “Dëshmorët e Gollakut”, p.n, Hajvali, Prishtinë,
Tel: 038 200 19 691,+383 (0)38 521 201
E-mail: zimp.ipk@rks-gov.net

1. Përmbledhja ekzekutive	
1.1. Informacion i përgjithshëm mbi rezultatet e inspektimit.....	(4-5)
1.2. Informacion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve.....	(5-5)
2. Hyrje	
2.1. Arsyet e inicimit të inspektimit.....	(6-6)
2.2. Qëllimi.....	(6-6)
2.3. Objektivat e inspektimit.....	(6-6)
2.4. Rëndësia e inspektimit.....	(7-7)
2.5. Metodologjia e inspektimit.....	(7-8)
3. Përshkrimi i objektit, gjetjet dhe rekomandimet	
3.1. Baza ligjore dhe kapacitetet për trajtimin e dhunës në familje.....	(10-14)
3.2. Indikatorët dhe trendët e dhunës në familje.....	(14-16)
3.3. Performanca policore në trajtimin e dhunës në familje.....	(17-25)
4. Plani për përmbushjen e rekomandimeve	
4.1. Plani i veprimit për realizimin e rekomandimeve.....	(26-29)
Shtojcat	

1. Përmbledhja ekzekutive

1.1. Informacion i përgjithshëm mbi rezultatet e inspektimit (gjetjet kryesore)

1.1.1. Dhuna në familje klasifikohet si shkelje e rëndë e të drejtave të njeriut. Lidhur me trajtimin e viktimave të dhunës në familje merret një varg institucionesh dhe kontributi i tyre konsiderohet i rëndësishëm. Edhe Policia është një nga akterët me një rol parandalues dhe hetimor në rastet e dhunës në familje. Fusha e dhunës në familje trajtohet brenda fushëveprimit të legjislacionit primar dhe sekondar. Legjislacioni primar përfshinë Kodin Penal dhe Ligjin për Mbrojtje nga Dhuna në Familje. Janë hartuar udhëzime administrative e procedura standarde vepruese në nivel kombëtar dhe policor që rregullojnë zbatimin e normave që rrjedhin nga kjo rregullativë. Policia e Kosovës trajton dhunën në familje në tre nivele: qendror, rajonal e lokal. Niveli qendror mbikëqyrë trajtimin e rasteve përmes Drejtorisë për Policimin në Bashkësi e Parandalim, kurse dy nivelet tjera merren me hetimin e rasteve, derisa barra kryesore bie mbi nivelin lokal (stacionet policore). Stacionet kanë të angazhuar hetuesit primar që merren me trajtimin e rasteve të raportuara dhe se këtë vit, nevojat për shtim të kapaciteteve me burime njerëzore janë përmbushur. Policia ka lëvizur drejt sigurimit të “dhomave mike”, si hapësira ambientale për trajtim të përkohshëm të viktimave gjatë qëndrimit në stacione, por që ende ka mungesa të hapësirave të tilla në mungesë të investimeve. Hetuesit primar kanë të kryera trajnimet e nevojshme nga fusha e dhunës në familje, por shtrohet nevoja që trajnimet e tilla të organizohen në masë më të gjërë edhe për personelin tjetër policor, si reagues të mundshëm në vendngjarje.

1.1.2. Trendet mbi numrin e rasteve të dhunës në familje tregojnë ngritje të numrit të rasteve nga viti në vit. Sipas statistikave të vitit 2020, ngarkesën më të madhe me raste e ka DRP Prishtinë me 32.6% të numrit të përgjithshëm të rasteve, derisa numër më të madh të rasteve për 1.000 banorë ka DRP Mitrovicë Veriu me 1.71 raste në 1.000 banorë. Grup mosha më e goditur e viktimave të dhunës mbetet ajo 20 - 30 vjet me 25.7% të numrit të përgjithshëm të viktimave. Viktimat meshkuj - femra të dhunës në familje përfaqësohen me raportin 22% : 78% në nivel të vendit. Kurse, “bashkëshortët” në marrëdhënie familjare përfaqësojnë pjesën më të madhe të viktimave me 44.6%. Krahasuar me tre vite të mëparshme, viti 2020 ka regjistruar numrin më të madh të vrasjeve të rënda të ndodhura në vend.

1.1.3. Viktimat e dhunës në familje, por dhe dëshmitarët kanë shfrytëzuar disa mundësi apo rrugë për denoncimin e rasteve dhe vërehet se ashtu siç edhe e ka pasur synim Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, numri i raportimeve ka shënuar ngritje krahasuar me vitet e kaluara. Ngritjes së numrit të raportimeve i kanë kontribuar edhe aktivitetet informuese dhe edukative të institucioneve dhe organizatave tjera joqeveritare, realizuar përmes të programeve edukative dhe fushatave vetedijesuese. Koha mesatare e reagimit të njërive policore në vendngjarje nga 111 mostra, llogaritet të jetë rreth 13 minuta, kohë kjo e konsideruar brenda limiteve të përcaktuara kohore. Marrë parasysh të dhënat nga raportet policore të katër viteve të fundit (2017/2020), Mbrojtësit e Viktimave janë kontaktuar nga njësitë policore në 2/3 e rasteve të raportuara (reaguara). Kontrolli i dosjeve vë në pah disa mangësi në dëshmimin e kryerjes së vlerësimit të riskut në trajtimin e rasteve dhe është e nevojshme që të organizohen trajnime mbi këtë fushë. Në 2/3 e dosjeve nuk janë gjetur dëshmi që stacionet policore kanë pajisur viktimat me “Pakon informuese”, përfshirë dhe kartelën e viktimës. Janë hasur dosje, kur viktimat edhe pse kanë pasur lëndime, dosjet nuk përmbajnë foto albumet mbi lëndimet e viktimave. Inspektimi ka

gjetur në shumë raste, kur të dyshuarve të mundshëm të dhunës në familje nuk iu është bërë testimi i prezencës së alkoolit në gjak, me gjithë indikacionet se kanë qenë konsumues të alkoolit. Nga 146 mostra është nxjerrë një mesatare e kohës mesatare të procedimit të lëndëve në Prokurori, me kallëzim penal apo me raport të veçantë. Kjo kohë del të jetë mesatarisht 11 ditë kalendarike në nivel vendi, derisa kjo nëpër drejtori rajonale lëvizë prej 3 deri në 18 ditë. Krahasuar me vitet e kaluara, në vitin 2020 është shënuar një ngritje e përqindjes së numrit të raporteve të drejtorive rajonale për nivelin qendror lidhur me rastet e dhunës familje (për Drejtorinë për Policimin në Bashkësi dhe Parandalim). Sipas të dhënave të drejtorive rajonale, ekipet hetimore të stacioneve policore kanë arritur që në vitin 2020, të procedojnë në Prokurori 92.6% të rasteve të regjistruara, derisa 7.4% janë bartur për hetim në vitin pasues. Kjo mesatare për katër vitet e fundit arrinë në kuotën prej 94% të rasteve të raportuara.

1.2. Informacion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve

1.2.1. Nga inspektimi i kryer ka rezultuar se nga katër (4) rekomandime të lëna nga inspektimi i kaluar (inspektimi nr. 6/2018), tre (3) prej tyre janë përmbushur plotësisht dhe një (1) nuk është përmbushur *(për më tepër referoju shtojcës 1)*.

2. Hyrje

2.1. Arsyet e inicimit të inspektimit

2.1.1. Departamenti i Inspektimit ka filluar punën në korrik të vitit 2006, kur është themeluar dhe vet agjencia. IPK synon të forcojë besimin e publikut në Policinë dhe këtë e bën përmes shqyrtimit të pavarur e raportimit objektiv. Në bazë të Ligjit nr. 03/L-231, IPK ka mandat ligjor që të kryejë inspektime në Polici, për të vlerësuar mënyrën e kryerjes së detyrave. Ky aktivitet mbikëqyrës ndihmon dhe mbështet Policinë për të siguruar shërbim profesional, demokratik e të përgjegjshëm. IPK-ja duke u bazuar në bazën ligjore, përveç inspektimeve të rregullta kryen edhe inspektime të jashtëzakonshme. Meqenëse, dhuna në familje po paraqitet si një shqetësim gjithnjë në rritje dhe sfidues për institucionet shtetërore, është e nevojshme që të trajtohet si dukuri e dukurive të dukura. Pas rastit të vrasjes së një gruaje (M.O) në qytetin e Ferizajt, Ministri i Punëve të Brendshme, z. Xhelal Sveçla ka kërkuar realizimin e një inspektimi të jashtëzakonshëm në Policinë e Kosovës, për të vlerësuar performancën në trajtimin e rasteve të dhunës në familje. Lidhur me këtë, Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së, më 26 gusht 2021 ka autorizuar inicimin e inspektimit të jashtëzakonshëm për të vlerësuar kryerjen e detyrave policore në këtë fushë të hetimit. Në bazë të kësaj, Departamenti i Inspektimeve ka zhvilluar inspektim për trajtimin e rasteve të dhunës në familje. IPK ka kryer edhe më parë inspektim të jashtëzakonshëm të kësaj fushe e që tani janë bërë tre vite nga realizimi i inspektimit të fundit nga kjo fushë, që kishte në fokus rregullativën ligjore për trajtimin e dhunës në familje, kapacitetet, performancën dhe respektimin e rregullave dhe procedurave gjatë trajtimit policor të rasteve të dhunës në familje. Inicimi i inspektimit është ndikuar edhe nga nevoja që Policia të sigurohet që taksat e qytetarëve janë duke u shfrytëzuar në mënyrë efektive dhe efikase në funksion të përmbushjes së objektivave ligjore të Policisë. IPK-ja është e interesuar të rishikojë edhe nivelin e përmbushjes së rekomandimeve të dhëna në inspektimin e kaluar, të pasqyruar në Raportin e inspektimit nr. 06/2018, të datës 7 shkurt 2019.

2.2. Qëllimi i inspektimit

2.2.1. Qëllimi i këtij inspektimi ka qenë:

- Që të përcaktojë nëse ligjet, rregulloret, si dhe parimet dhe procedurat policore përkatëse zbatohen si duhet dhe nëse janë të përshtatshme për të arritur qëllimet;
- Që të përcaktojë nëse burimet shfrytëzohen në mënyrë efektive, efikase dhe nëse janë të përshtatshme për të arritur qëllimet dhe objektivat;
- Që të jepet një opinion objektiv mbi çështjet që lidhen me trajtimin e dhunës në familje;
- Që të parandalojë shkeljet eventuale që mund të kryhen gjatë punës në fushën përkatëse;
- Që të identifikojë mangësitë - dobësitë dhe rekomandoj masa për funksionim më të mirë.

2.3. Objektivat e inspektimit

2.3.1. Objektivat që synon t'i arrijë ky inspektim janë:

- Vlerësimi i bazës ligjore dhe kapaciteteve për hetimin e rasteve të dhunës në familje;
- Analizimi dhe vlerësimi i indikatorëve që lidhen me rastet e dhunës në familje;
- Vlerësimi i performancës policore për hetimin e rasteve të dhunës në familje;
- Vlerësimi i respektimit të procedurave gjatë hetimit të rasteve të dhunës në familje.

2.4. Rëndësia e inspektimit

2.4.1. Inspektimi në këtë fushë të menaxhimit luan rol të rëndësishëm në:

- Ngritjen e performancës policore në trajtimin e rasteve të dhunës në familje;
- Ngritjen e përgjegjësisë së punonjësve policor dhe llogaridhënies në punë;
- Ngritjen e imazhit dhe besimit të Policisë në raport me qytetarët dhe viktimat e dhunës në familje.

2.5. Metodologjia e inspektimit

2.5.1. Në këtë inspektim të jashtëzakonshëm është vlerësuar kryerja e detyrave gjatë trajtimit policor të rasteve të dhunës në familje. Inspektimi është përqendruar në drejtoritë rajonale policore, konkretisht në sektorët rajonal të hetimeve. Gjetjet e këtij inspektimi duhet të jenë në interes të të gjithë akterëve, përfshirë strukturën hetimore dhe nivelet mbikëqyrëse dhe vendimmarrëse.

2.5.2. Gjatë inspektimit është aplikuar një metodologji adekuate inspektuese e cila ofron mundësi për të siguruar informacionin e nevojshëm në interes të nxjerrjes së opinionit objektiv mbi proceset e fokusuara. Në këtë drejtim:

- a) Janë zhvilluar takime- intervista me 19 drejtues, punonjës e bartës funksionesh, përfshirë: Udhëheqësit rajonal të hetimeve, Mbikëqyrësit e Ekipeve për Hetime të Veprave Penale, Dhunë Familjare dhe Delikuencë të të Miturve dhe Shefi i Sektorit për Dhunë në Familje në kuadër të Drejtorisë për Policim në Bashkësi dhe Parandalim;
- b) Janë kryer inspektime - kontrole fizike të 146 dosjeve të rasteve të hetimit të dhunës në familje për vitet 2020 dhe 2021 të stacioneve policore dhe sektorëve rajonal të hetimeve;
- c) Janë marrë dokumente të shkruara, si: dëshmi mbi kapacitetet, raporte peridike të punës së njësive hetimore dhe kopjet e dosjeve të rasteve (146 sosh).

2.5.3. Bazuar në Programin e punës inspektuese, inspektimi ka filluar më 30.08.2021 dhe është planifikuar të përfundojë më 03.09.2021, por takimet konsultuese me zyrtarët përgjegjës policor kanë vazhduar edhe përtej datës së planifikuar të përfundimit të punës në terren. Inspektimi është përqendruar në vlerësimin e kryerjes së detyrave policore gjatë periudhës dy vjeçare (2020/2021) dhe gjendjen aktuale.

2.5.4. Për përmbushjen e objektivave, inspektimi është fokusuar në këto drejtime kryesore:

- Baza ligjore dhe kapacitetet për trajtimin e dhunës në familje,
- Indikatorët dhe trendët e dhunës në familje,
- Performanca policore në trajtimin e rasteve të kësaj natyre.

2.5.5. Dokumentet në vijim janë baza themelore (standardet), në të cilën është mbështetur puna e inspektorëve gjatë vlerësimit të kryerjes së detyrave:

- Ligji nr. 04/L-076 për Policinë;
- Kodi i Procedurës Penale të Kosovës;
- Kodi Penal i Kosovës;
- Ligji nr. 03/L-182 për Mbrojtje nga Dhuna në Familje;
- Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje në Kosovë;

- Procedura Standarde e Operimit - Hetimi i Dhunës Familjare (PK/ShH-PSO 1.17);
- Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Plani i Veprimit 2016-2020.

2.5.6. Gjatë punës në terren dhe pasqyrimin të gjetjeve në raportin e zgjeruar të inspektimit, nuk ka hasur në ndonjë vështirësi që do të ndikonte në përmbushjen me sukses të objektivave të vëna me Programin e punës. Inspektorët kanë hasur në një bashkëpunim të kënaqshëm të personelit policor. Raporti përfundimtar iu ka nënshtuar proceseve të brendshme të kontrollit të cilësisë. Po ashtu, është realizuar edhe takim me përfaqësues të strukturës policore, ku janë diskutuar gjetjet, rekomandimet dhe plani i implementimit të tyre (13.10.2021).



Dhuna në familje

Numri i rasteve të raportuara (2020) – trendi	2.069 (+8.1%)
Trendi i krimit në 1.000 banorë (2020)	1.16 raste
Numri i viktimave - raporti (2020)	2.101 viktima (22% M : 78% F)
Numri i vrasjeve (2020)	13 vrasje (0.72 në 100.000)
Viktima në marrëdhënie bashkëshortore (2020)	937 viktima (44.6%)
Regjioni më i goditur me raste	DRP Prishtinë (32.6%)
Regjioni më i goditur për 1.000 banorë	1.71 raste (Mitrovicë Veriu)
Grup mosha më e goditur e viktimave	20-30 vjet (25.7%)



Aktiviteti policor

Koha e reagimit policor	13.5 minuta (111 mostra)
Numri i përgjithshëm i të arrestuarve (2020)	914 (44.2%)
Numri i përgjithshëm i të ndaluarve (2020)	303 (14.6%)
Njoftimet e Mbrojtësit të Viktimës (2020)	1.355 (65.5%)



Performanca policore hetimore

Përqindja e procedimeve penale (2020)	92.6%
Përqindja e rasteve nën hetim (2020)	7.4%
Kallëzime penale (2020)	1.907 (92.2%)

3. Përshkrimi i objektit, të gjeturat dhe rekomandimet

3.1. Baza ligjore dhe kapacitetet për trajtimin e dhunës në familje

3.1.1. Trajtimi i rasteve të dhunës në familje në Kosovë përveç që është i rregulluar me ligjet bazike (Kodin Penal të Kosovës, si dhe Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Kosovës), është i rregulluar edhe me ligj të veçantë - Ligjin për Mbrojtje nga Dhuna në Familje. Dhuna në familje me Kodin Penal të Republikës së Kosovës është përcaktuar si vepër penale e veçantë¹, e cila ndiqet ex-officio. Neni 248, paragrafi 1 përcakton se *“Kushdo që kryen dhunën ose keqtrajtimin fizik, psikologjik ose ekonomik me qëllim të cenimit të dinjitetit të personit tjetër mbrenda një marrëdhënieje familjare, dënohet me gjobë dhe burgim deri në 3 (tre) vjet”*. Paragrafi 2 i këtij neni ka paraparë se *“Kur çfarëdo vepre në Kodin Penal kryhet brenda marrëdhënies familjare, do të konsiderohet si rrethanë rënduese”*. Ligji për Mbrojtje nga Dhuna në Familje në thelb e përkufizon dhunën në familje, brenda një marrëdhënieje familjare, me qëllim të parandalimit dhe mbrojtjes së viktimave nga shfaqja ose rishfaqja e akteve të dhunës në familje me lëshimin e urdhrave mbrojtës. Me këtë Ligj, Urdhri për Mbrojtje, Urdhri për Mbrojtjen Emergjente dhe Urdhri i Mbrojtjes së Përkohshme Emergjente janë tre (3) lloje të urdhrave mbrojtës që përcaktohen në përputhje me autoritetin e organit që i lëshon ato. Kjo përfshinë edhe llojet e masave që mund të lëshohen me urdhrat mbrojtës. Neni 26, paragrafi 1 i Ligjit, parasheh se shkelja e urdhrave mbrojtës, gjithashtu paraqet bazë për ndjekje penale sipas detyrës zyrtare. Po ashtu, me nenin 24 të Ligjit janë përcaktuar edhe përgjegjësitë e Policisë në trajtimin e rasteve të dhunës në familje.

3.1.2. Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës detyron subjektet publike të raportojnë krimet që duhet të ndiqen sipas detyrës zyrtare. Në nenin 63, paragrafi 2, theksohet rritja e rolit të Mbrojtësit të Viktimave për të përfaqësuar viktimat e krimit. Megjithatë, me Kodin e ri, pala e dëmtuar ose viktimat konsiderohen të njëjtë, të përkufizuar si *“personi, të cilit çfarëdo e drejte personale ose pasurore i është shkelur ose i është rrezikuar me veprën penale”*. Rritja e rolit të Mbrojtësit të Viktimave gjithashtu parasheh të drejtën e kërimit në emër të viktimës, të sqarimeve për dëmet dhe shumën e kompensimit të kërkuar me anë të parashtrimit të një deklaratë të thjeshtë mbi dëmet. Dëmet e pretenduara mund të jenë fizike, financiare dhe emocionale, dhe mund të përmendin ndonjë rrethanë të ndryshuar të jetës.

3.1.3. Sipas dispozitave të Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, Qeveria e Republikës së Kosovës ka miratuar aktet nënligjore me qëllim të trajtimit të rasteve të kryesve të veprave të dhunës në familje, si: Udhëzimin Administrativ nr. 12/2012 për përcaktimin e vendit dhe mënyrës së trajtimit psiko-social të kryesit të dhunës në familje dhe Udhëzimin Administrativ nr. 02/2013 për mënyrën e trajtimit të kryesve të dhunës në familje, ndaj të cilëve është shqiptuar masa e mbrojtjes e trajtimit të obligueshëm mjekësor nga varësia e alkoolit e substancave psiko - tropike. Këto akte fokusohen vetëm në nevojën për kryesit e varur nga alkooli e droga, që të trajtohen nga shteti, duke identifikuar ato si shkaqe të mundshme të akteve të dhunës në familje. Aktet nënligjore lejojnë krijimin e licencimit e organizatave jo qeveritare, si dhe të agjencive qeveritare përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve shëndetësore e sociale për të ofruar trajtime të detyrueshme, të urdhëruara nga gjykata (kjo përfshinë ndihmën e ofruar në nivel komunal). Procedurat Standarde të Veprimit të miratuara në vitin 2013 nga Zyra e Koordinatorit Nacional kundër Dhunës në Familje gjithashtu ofrojnë hollësi për rolet ligjore dhe institucionale dhe përgjegjësitë e institucioneve të

¹ Kodi Penal i Kosovës, Kapitulli XXI, Neni 248 - Dhuna në familje.

pavarura, Gjykatave, Prokurorisë, Policisë, dhe për Organizatat Jo Qeveritare ofruese të shërbimeve. Kuadri ligjor kombëtar plotësohet më tej dhe me Programin e Kosovës kundër Dhunës në Familje dhe Planin e Veprimit - në vazhdimësi të të cilit është pikërisht hartimi i Strategjisë kombëtare.

3.1.4. Policia e Kosovës, si akter kyç për trajtimin e rasteve të dhunës në familje, ka hartuar një sërë dokumentesh si Procedura Standarde të Operimit, me të cilat përcaktohen hapat dhe veprimet konkrete policore për zbatimin e dispozitave që dalin nga aktet ligjore mbi rastet e dhunës në familje. Departamenti i Hetimeve të Policisë ka miratuar Procedurë Standarde të Veprimit - Hetimi i dhunës familjare, e cila ka vënë në përgjegjësi për zbatim të saj të gjitha njësitë policore të nivelit qendror dhe lokal. Ky dokument parasheh veprime që duhet të ndërmerren nga zyrtarët policor gjatë trajtimit të rasteve të dhunës në familje, e që derivojnë nga Ligji nr. 03/L-182 për Mbrojtje nga Dhuna në Familje. Dokumenti në fjalë përfshinë kapitujë që përcaktojnë ndjekjen e veprave penale që kanë të bëjnë me dhunën në familje, përgjegjësitë e personelit, procedurën që duhet ndjekur gjatë trajtimit të rasteve, procedurën sipas Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, ndërhyrjet e Policisë në rastet e dhunës në familje, detyrat e Pranuesit të Thirrjes (dispeqerit), detyrat e patrullës policore në reagimin e rasteve të dhunës në familje, detyrat e hetuesve (hetuesit primar) në hetimin e rasteve, intervistimin e viktimës/e të dyshuarit/dëshmitarëve, intervistimin e fëmijëve, detyrat e Hetuesit rajonal të dhunës në familje, etj.

3.1.5. Në inspektimin e jashtëzakonshëm të realizuar në vitin 2018 në këtë fushë, IPK ka vlerësuar se kapitujtë e përfshirë në Procedurën Standarde të Veprimit janë në harmoni me aktet ligjore, përgjegjësitë e Policisë së Kosovës që janë përcaktuar në Ligjin për Mbrojtje nga Dhuna në Familje janë inkorporuar në Procedurën Standarde të Veprimit, por se disa pika të përcaktuara me Ligjin për Mbrojtje nga Dhuna në Familje² nuk janë trajtuar si pika të veçanta në Procedurën Standarde të Veprimit. Lidhur me këtë, IPK kishte rekomanduar që Policia e Kosovës duhet të plotësoj/ndryshoj dokumentin e Procedurës Standarde të Veprimit për Hetimin e Dhunës Familjare, më qëllim që ky dokument të jetë në harmoni të plotë, duke përfshirë të gjitha pikat që janë paraparë me Ligjin nr. 03/L-182 për Mbrojtje nga Dhuna në Familje. Policia kishte pranuar rekomandimin e dhënë duke u zotuar se do të përmbushte deri në fillim të vitit 2019. Inspektimi i realizuar së fundmi vë në pah se Policia ka marrë iniciativë që të bëjë ndryshimet e nevojshme të dokumentit në fjalë, por që ende nuk është finalizuar (për momentin PSO gjendet në fazën e draftimit).

Rekomandimi nr. 1

IPK-ja përseri i rekomandon Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë që të shtyjë para procesin e finalizimit për ndryshimin e Procedurës Standarde të Veprimit - Hetimi i Dhunës Familjare (PK/SHH-PSO 1.17), më qëllim harmonizimi të plotë me Ligjin nr. 03/L-182 për Mbrojtje nga Dhuna në Familje.

3.1.6. Sipas Procedurës Standarde të Veprimit - Hetimi i Dhunës Familjare (PK/SHH - PSO 1.17), Kapitulli VI - Personeli, pika 6.3 parasheh që “së paku dy hetues për stacion nga njësitë e hetuesisë duhet të jenë të zgjedhur si hetues primar të dhunës në familje për hetimin e rasteve për dhunë në familje dhe rastet e keqtrajtimit të fëmijëve”. Gjatë inspektimit, IPK ka vërejtur se kryesisht shumica e stacioneve policore kanë nga dy hetues të dhunës në familje, derisa ka edhe stacione që kanë angazhuar edhe tre hetues. Përgjithësisht stacionet policore janë të kënaqur me numrin aktual të hetuesve për të mbuluar hetimin e rasteve të tilla dhe kujdestarinë 24/7. Nga data 01.04.2021 me kërkesë të Drejtorit të

²Pikat e cekura në nenin 24 të Ligjit në fuqi.

Departamentit për Operacione janë shtuar kapacitetet dhe në stacionet e kategorisë A është shtuar numri i hetuesve nga dy në tre, derisa në stacionet e kategorisë B dhe C, numri i këtyre zyrtarëve është shtuar nga një në dy. Shtimi i kapaciteteve ka përfshirë edhe nivelin rajonal, ku njësitë rajonale hetimore tanimë kanë nga dy zyrtarë që trajtojnë rastet e dhunës në familje. IPK-ja ka parasysh përcaktimet dhe synimet që dalin nga Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Plani i Veprimit 2016-2020, sipas së cilës parashihet në kuadër të Objektivit strategjik 1: Parandalimi dhe vetëdijesimi, ngritja e kapaciteteve të shërbimeve profesionale, përfshirë dhe punonjësit e Policisë në masën prej 50% deri në vitin 2020. Policia e Kosovës ka marrë parasysh kërkesat e njëjësive hetimore dhe numrin e rasteve, duke u orientuar në përmbushjen e objektivit strategjik për ngritjen e kapaciteteve, në drejtim të trajtimit të duhur të rasteve të dhunës në familje.

3.1.7. IPK-ja ishte e interesuar të mësoj se si aplikohet në praktikë ndarja e kompetencës së hetimit të rasteve të dhunës në familje ndërmjet nivelit të stacioneve policore dhe sektorëve rajonal të hetimeve. Mbikqyrësit e Ekipave për Hetim të Veprave Penale “Dhunë Familjare e Delikuencë të të Miturve” në kuadër të drejtorive rajonale kanë njoftuar se të gjitha rastet, të cilat cilësohen raste të dhunës në familje trajtohen dhe hetohen në nivel të stacioneve policore. Kur në rastet e dhunës në familje, si kryes apo si viktimë janë përfshirë zyrtarët publik, atëherë rastet hetohen nga Ekipet për Hetime të Veprave Penale “Dhunë Familjare e Delikuencë të të Miturve”, në nivel të sektorëve rajonal për hetime. Tutje kësaj, në bazë të informatave të siguruara nga inspektimi, kur rastet e rënda penale (vrasjet, plagosjet, dhunimet, etj.) pa marrë parasysh se a kanë ndodhur në familje apo jashtë saj, hetohen nga Njësia për Hetimin e Krimeve të Përgjithshme në nivel rajonal. Nëse këto raste kanë ndodhur brenda familjes, Ekipet për Hetime të Veprave Penale “Dhunë Familjare dhe Delikuencë të të Miturve” i mbështesin Njësitë për Hetimin e Krimeve të Përgjithshme në hetimin e këtyre rasteve.

3.1.8. Meqenëse përshkak të ndjeshmërisë së rasteve, viktimat e dhunës në familje duhet trajtuar në mënyrën e duhur, duke u ofruar kujdesin e nevojshëm, është shumë më rëndësi që të mendohet për aspektet ambientale. IPK ishte e interesuar të verifikoj nëse Policia, përkatësisht stacionet policore kanë ambiente, hapësira apo zyre të përshtatshme për trajtimin e viktimave të dhunës në familje, gjatë kohës së qëndrimit të tyre në stacionet policore. IPK ka siguruar të dhëna mbi numrin e dhomave apo zyreve që përdoren për trajtimin e viktimave të dhunës për periudhën e qëndrimit të tyre në stacione policore. Janë gjithsej 17 dhoma të tilla, të shpërndara në të gjitha drejtoritë rajonale (Prishtinë - 3, Gjilan - 2, Pejë - 2, Prizren - 2, Mitrovicë Jugu - 2, Ferizaj - 1, Gjakovë - 2 dhe Mitrovicë Veriu - 3). Nga të dhënat del se nga 41 stacione policore, 16 apo 39% prej tyre kanë dhoma të tilla. Sa i përket drejtorive rajonale, me dhoma mike janë të pajisur dhe njësitë rajonale të hetimit të dhunës në familje në Ferizaj e Gjakovë. Mungesa e këtyre ambienteve arsyetohet me mungesë të investimeve për realizimin e tyre, ngase realizimi i këtyre projekteve ka kosto të konsiderueshme buxhetore. Policia e Kosovës duhet që të përgatisë dhoma edhe në stacionet tjera, me qëllim që viktimave t’u ofrohet trajtim i dinjitetshëm.

Rekomandimi nr. 2

IPK-ja i rekomandon Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë dhe Drejtorit të Departamentit për Shërbime Mbeshtetëse, që në të ardhmen brenda mundësive buxhetore, të planifikojnë dhe realizojnë ndarjen dhe funksionalizimin e ambienteve të veçanta si “dhoma mike”, si praktika të mira të aplikuara në vendet e zhvilluara, për trajtimin e viktimave të dhunës në familje.

3.1.9. Trajtimi i rasteve që kanë të bëjnë me dhunën në familje është një fushë mjaft e ndërlikuar dhe e ndjeshme. Andaj, është e nevojshme që hetuesit, të cilët merren me hetimin e rasteve të tilla të kenë një ngritje profesionale dhe njohuri nga fushat përkatëse. IPK ka kërkuar nëse të gjithë hetuesit

e caktuar për trajtimin e dhunës në familje kanë Kursin Bazik për Hetime dhe atë për Hetimin e Dhunës në Familje. Hetuesit primar të dhunës në familje, në të gjitha stacionet policore, veç Kursit Bazik të Hetimeve, kanë ofruar dëshmi se kanë të kryer edhe Kursin për Hetimin e Dhunës në Familje. Veç trajnimeve bazike për hetimin e dhunës në familje, të gjeturat tregojnë se Policia është kujdesur në ngritjen profesionale të hetuesve të dhunës në familje, duke organizuar edhe trajnime dhe seminare të ndryshme, të cilat lidhen drejtpërdrejt me fushën e hetimit të rasteve të dhunës në familje, si: hetimi i dhunës në familje, implementimi i urdhrave për mbrojtje nga dhuna në familje, intervistimi hetimor i të miturve dhe menaxhimi i dhomave të intervistimit, roli i Policisë sipas Ligjit kundër Dhunës në Familje. Hetuesit e dhunës në familje janë të trajnuar për trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe Policia inkurajohet të vazhdojë me trajnime të tilla, në mënyrë që trajtimi i këtyre rasteve të bëhet në mënyrën më profesionale të mundshme. Në vitin 2019 në bashkëpunim me institucionet vendore dhe ndërkombëtare janë mbajtur gjithsej dhjetë (10) trajnime lidhur me dhunën në familje me rreth 500 pjesëmarrës. Në vitin 2020 në bashkëpunim me Drejtorinë për Policim në Bashkësi e Parandalim, dhe OSBE-në janë organizuar pesë (5) trajnime me 200 policë pjesëmarrës dhe mbikëqyrës të vijës së parë, kurse në bashkëpunim me Këshillin e Evropës janë realizuar dy (2) trajnime me 80 përfaqësues institucionesh, të përfshirë në trajtim të dhunës në familje, përfshirë dhe katër (4) pjesëmarrës policor. Në vitin 2021 janë realizuar tetë (8) trajnime ku kanë marrë pjesë 320 pjesëmarrës. IPK-ja vlerëson se veç personelit të hetimeve në stacione policore, është e nevojshme që edhe personeli tjetër policor i njësive patrulluese, të jetë i trajnuar mjaftueshëm për fushën e dhunës në familje, ngase tek rastet e dhunës në familje, njësitë e para që ballafaqohen me rastet, veç hetuesve të dhunës në familje, janë edhe policët e njësive patrulluese që angazhohen në përgjigje të këtyre rasteve.

Rekomandimi nr. 3

IPK-ja i rekomandon Udhëheqësit të Divizionit të Trajnimeve dhe Drejtorëve Rajonal që në të ardhmen, brenda programeve trajnuese nga fusha e dhunës familjare, të përfshihet dhe personeli policor i njësive patrulluese (reaguese, sektoriale), me synimin që njësitë e tilla të kenë njohuritë e duhura për të reaguar në rastet e dhunës në familje.


3.2.10. Hetuesit primar duhet të jenë në thirrje 24 orë për të gjitha rastet e dhunës në familje, të cilët do të përgjigjen në thirrje në vendin e ngjarjes dhe hetimit të rastit. Kur hetuesit primar të dhunës në familje nuk janë në detyrë, apo nuk mund t'i përgjigjen rasteve të tilla, hetuesit tjerë nga njësitë e hetuesisë mund ta hetojnë rastin, mirëpo duhet të bashkëpunojnë me hetuesin e dhunës në familje. Ndërsa, obligim i njësive patrulluese, të cilat i përgjigjen rastit të raportuar të dhunës në familje është që të njoftoj për të dalur në vendngjarje, njësinë e hetimeve (hetuesin primar të dhunës në familje) dhe njësitë tjera kompetente. Duke u bazuar në shkresat e zyrtarëve policor kompetent për stacionet policore, si dhe raporteve të trajtimit të rasteve të dhunës në familje, shihet se Policia bën përpjekje maksimale që rastet e raportuara si dhunë në familje të trajtohen nga hetuesit primar të dhunës në familje. Sipas këtyre informatave, përveç rasteve kur nuk arrijnë të mbulohen me personel (përshkak të mungesave të personelit në disa stacione kryesisht të kategorisë A), rastet e raportuara trajtohen nga hetuesit primar të dhunës në familje. Sa i përket kujdestarisë në thirrje 24 orë, hetuesit e dhunës në familje do t'i përgjigjen thirrjeve për të gjitha rastet e dhunës në familje. Duhet theksuar se hetuesit primar të dhunës në familje iu përgjigjen rasteve që raportohen si dhunë në familje, por edhe këtu për shkak të mungesave të hetuesve, mund të ketë përjashtime, ngase numri prej dy hetuesve primar në stacione nuk është i mjaftueshëm që të mund të mbulohet kujdestaria 24 orë në thirrje. Në rastet kur është e pamundur që hetuesi primar t'i përgjigjet rastit, atëherë inkuadrohet hetuesi tjetër, por në të njëjtën kohë informohet hetuesi primar i dhunës në familje.

3.2.11. Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Mbrojtje nga Dhuna në Familje 2016-2020 ka paraparë tek objektivat strategjike disa objektiva specifike lidhur me ndërgjegjësimin dhe vetëdijësimin mbi dhunën në familje. Tek Objektivi Strategjik 1: Parandalimi dhe vetëdijësimi, është vënë Objektivi specifik: Rritja e vetëdijësimit të shoqërisë për të mos pranuar dhe për të mos toleruar ushtrimin e dhunës në familje. Nga përmbushja e këtij objektivi, pritet me Planin e Veprimit, rritja me të paktën 20%, deri në vitin 2020, e numrit të individëve të shoqërisë të vetëdijësuar, për format e ndryshme të dhunës, të cilët besojnë se dhuna në familje është e patolerueshme. Në këtë drejtim, IPK-ja ka identifikuar një varg aktivitetesh për senzibilizimin e luftës kundër dhunës në familje. Në bashkëpunim me Drejtorinë për Policimin në Bashkësi dhe Parandalim, në tre (3) vitet e fundit janë organizuar 1.019 ligjërata me 13.216 pjesëmarrës, ku zyrtarët policor kanë synuar ndërgjegjësimin e qytetarëve lidhur me dhunën në familje. Shumica e ligjëratave është realizuar nëpër shkolla dhe institucione. Në bashkëpunim dhe me përkrahje të UN Woman, OPDAT, ICITAP dhe OSBE, në tre (3) vitet e fundit janë shpërndarë 43.000 broshura (fletushka) vetëdijësuese mbi pasojat e dhunës në familje, rolin e institucioneve dhe mënyrat e raportimit. Nën organizimin e Drejtorisë për Policim në Bashkësi dhe Parandalim, dhe institucioneve tjera, në tre vitet e fundit janë organizuar 28 tryeza me 1.060 pjesëmarrës (nxënës, prind, qytetar dhe këshilla lokale për siguri). Gjatë tre viteve të fundit, Drejtoria për Policim në Bashkësi dhe Parandalim ka marrë pjesë në 28 aktivitete mediale për dhunën në familje. Në bashkëpunim me Zyrën për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun, si dhe KFOR-in janë realizuar 26 audio produkte lidhur me dhunën në familje. Në dy vitet e fundit, në bashkëpunim me OSBE-në, Ministrinë e Shëndetësisë, Agjencinë për Barazi Gjinore janë mbajtur 80 punëtori, ku Policia ka pasur numër të konsideruar pjesëmarrësish. IPK-ja vlerëson se aktivitetet e tilla kanë rol të rëndësishëm në vetëdijësimin e qytetarëve dhe senzibilizimin për luftimin e dhunës në familje. Këto edhe mund të kenë ndikuar pozitivisht në ngritjen e numrit të raportimeve.

3.2. Indikatorët dhe trendët e dhunës në familje


3.2.1. Viteve të fundit, dhuna në familje po konsiderohet si një dukuri e shpeshtë që po tërheqë vëmendjen e qytetarëve dhe shumë organizatave që merren me promovimin e vlerave të shoqërisë dhe senzibilizimin e luftimit të rasteve të kësaj natyre. Marrë parasysh statistikat e publikuara nga Policia e Kosovës, rastet e raportuara të dhunës në familje kanë trend rritës të vazhdueshëm. Duke shikuar trendët e katër viteve të fundit, kjo formë e dhunës ka shënuar rritje të dukshme të numrit të rasteve. Në vitin 2018, numri i rasteve ka shënuar ngritje për 20.8% krahasuar me vitin paraprak, pasuar me një ngritje edhe më të lartë në vitin 2019 për 24.9%. Në vitin 2020 edhe pse kjo ngritje ka vazhduar tutje, arrinë në lartësi prej 8.1%. Marrë për bazë strukturën e shpërndarjes së rasteve, shihet se në vitin 2020, 32.6% e rasteve të raportuara të dhunës në familje kanë ndodhur në zonën e përgjegjësisë që kontrollon DRP - Prishtinë, që e bën më të ngarkuarën me raste të kësaj natyre. Në anën tjetër, në DRP - Mitrovicë Veriu është shënuar përqindja më e ulët e këtyre rasteve që në numrin e përgjithshëm të rasteve shënon një përqindje prej 3.2%. Nëse i hedhim një sy edhe trendit për periudhën gjashtëmujore të vitit 2021 krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, shihet se ka vazhduar trendi në ngritje prej 12.4%. Muaji gusht rezulton të jetë më i ngarkuari me raste të raportuara të dhunës në familje në tre nga katër vitet e fundit. Kurse, sa i përket grup moshës më të goditur, të dhënat pasqyrojnë se në vitin 2020, 25.7% e viktimave i takojnë grup moshës 20 - 30 vjet, pasuar nga grup moshës 30 - 40 vjet e përfaqësuar me 24% të numrit të viktimave.

Diagrami 1 - Trendi i rasteve të dhunës në familje 2017-2020



3.2.2. Nëse nxjerrim një mesatare të përgjithshme në nivel vendi për numrin e rasteve për 1.000 banorë që del të jetë 1.16 raste për vitin 2020, shihet se gjendjen më të rënduar e hasim në zonën e përgjegjësisë që kontrollon DRP - Mitrovicë Veriu (1.71 raste në 1.000 banorë), DRP - Prishtinë (1.39) dhe DRP - Gjilan (1.28), duke përfaqësuar kështu zonat më të nxehta apo më të dhunshme sa i përket dhunës në familje³. Në anën tjetër, në zonën e përgjegjësisë së DRP - Mitrovicë Jugu dhe DRP - Prizren është regjistruar numër më i ulët i rasteve të tilla, duke u cilësuar si regjione më pak të dhunshme (0.76 dhe 0.92 raste në 1.000 banorë). Regjionet tjera kanë numër të rasteve që ndodhen në suaza të mesatares së përgjithshme për 1.000 banorë. Trendi i përgjithshëm i rasteve për 1.000 banorë në vitin e fundit ka shënuar një ngritje për 0.09 raste. Në përjashtim të DRP - Prizren që ka shënuar një rënie të numrit të rasteve për 1.000 banorë nga 0.99 në 0.92, të gjitha regjionet tjera kanë pasur ngritje të numrit të rasteve. DRP - Mitrovicë Jugu ka shënuar ngritje më të madhe të numrit të rasteve krahasuar me një vit para, nga 0.58 në 0.76 raste në 1.000 banorë. Sido që të jetë, zona e përgjegjësisë së DRP - Mitrovicë Jugu mbetet regjioni me numër më të ulët të rasteve për 1.000 banorë. Analiza mbi numrin e rasteve për 1.000 banorë mund t'iu shërbejë strukturave policore në të ardhmen për të analizuar trendet sipas zonave, për të identifikuar planet apo veprimet e tyre në parandalimin dhe luftimin e dhunës në familje.


Diagrami 2 - Trendi i rasteve të dhunës në familje për 1.000 banorë (2019/2020)



3.2.3. Sipas evidencave të shumë shteteve, femrat dalin të jenë në pjesën më të madhe të rasteve, viktima të dhunës në familje. Sipas raporteve vjetore policore dhe analizave të bëra nga IPK, diku 4 nga 5 viktima të dhunës në familje del të jenë të gjinisë femërore. Raporti i viktimave të dhunës në familje sipas gjinisë (meshkuj-femra) në vitin e fundit sillet 22% : 78%. Ky raport përgjatë katër viteve të fundit nuk ka ndryshuar shumë, në përjashtim të atij të vitit 2019, kur ka arritur në 19.5% : 80.5%. Në vitin e kaluar është një shënuar një ngritje e lehtë e përqindjes së viktimave të gjinisë mashkullore krahasuar me tre vitet paraprake.


³ Kalkulimet janë bazuar në të dhënat e Vjetarit Statistikor të Agjencisë së Statistikave të Kosovës. Numri i banorëve të komunave është përmbledhur në ndarjet përkatëse sipas zonave të përgjegjësisë së drejtorive rajonale. Informatat mbi numrin e banorëve sipas komunave është i pasqyruar në shtojcë të këtij Raporti.

Diagrami 3 - Përqindja e pjesëmarrjes së viktimave sipas gjinisë (2020)



3.2.4. Modeli i pasqyrimit të viktimave varësisht pozicionit brenda marrëdhënies familjare, ka krijuar një model unik të raportimit, ku të gjitha stracionet dhe drejtoritë rajonale që trajtojnë rastet e dhunës në familje, prezantojnë numrin e viktimave me çka mundësohet edhe krahasimi i tyre në baza periodike. Këto evidenca tregojnë se afërsisht gjysma e viktimave të dhunës në familje kanë qenë në marrëdhënie familjare “bashkëshortë” (44.6%), pasuar me viktimat në marrëdhënie familjare “babë - djalë” me 11.5%.

Diagrami 4 - Marrëdhënia familjare e viktimave (2019-2020)



3.2.5. IPK ka pasur në fokus edhe llojet e veprave penale të kryera brenda dhunës në familje dhe sidomos në vitin e fundit kemi pasur një ngritje të numrit të “vrasjeve të rënda” nga 5 sa ishin për secilin nga vitet e mëhershme, në 13 në vitin 2020. Në vitin 2017, 2018 dhe 2019, llogaritur në 100.000 banorë, në vendin tonë ka ndodhur 0.28 vrasje lidhur me dhunën në familje, kurse në vitin e kaluar kjo shifër është ngritur në 0.72. Nga të dhënat tabelore vërehet se “lëndimi i lehtë trupor”, “sulmi” dhe “kanosja” janë ndër veprat më të shpeshta të lidhura me dhunën në familje.

Viti vepra	Lëndim i lehtë trupor	Sulm	Kanosje	Lëndim i rëndë trupor	Vrasje e rëndë	Të tjera	Gjithsej
2017	41.4%	23.6%	14.7%	2.6%	0.4%	17.2%	100%
2018	48.5%	20.7%	18.1%	1.5%	0.3%	17.4%	100%
2019	29.2%	15.3%	10.8%	0.9%	0.3%	43.5%	100%
2020	19.6%	8.2%	7.3%	0.7%	0.6%	63.6%	100%

3.3. Performanca policore në trajtimin e dhunës në familje

3.3.1. Çdo rast (shqetësim) që konsiderohet se bie në fushën e detyrave e përgjegjësiive policore, qytetarët mund ta paraqesin përmes linjës telefonike në numrin 192. Edhe për rastet e dhunës në familje, raportimi i tyre mund të bëhet përmes kësaj thirrjeje, në të cilën lajmërohet dispeçeri, i cili sapo të marrë informacionin se rasti ka të bëjë me dhunën në familje, lajmëron hetuesit përgjegjës që të reagojnë në rast. Sipas drejtuesve të Drejtorisë për Policimin në Bashkësi dhe Parandalim, veç linjës telefonike 192, qytetarët për denoncimin e rasteve të dhunës në familje mund të shfrytëzojnë dhe linjën e veçantë në numrin 080019999. Lidhur me këtë të fundit, Policia e Kosovës ka përmbushur një obligim që rrjedhë nga neni 24, paragrafi 3.1 të Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje⁴, lidhur me sigurimin e linjës së posaçme telefonike. Kjo duket të mos ketë qenë linja e vetme në dispozicion, meqë është krijuar dhe një linjë publike falas 080011112 në funksion 24 orë, menaxhuar nga Divizioni për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave në kuadër të Prokurorisë së Shtetit. Nga inspektimi i realizuar konstatohet se qytetarët shfrytëzojnë dhe kanale tjera të raportimit, qoftë përmes deklaratimit fizik në stacion nga vetë viktimat apo persona tjerë, apo edhe në forma tjera, si: atë elektronike, përmes Qendrës për Punë Sociale, Njësisë për Mbrojtjen e Viktimave, si dhe Qendrave Mjekësore. Nga praktikat e kaluara, mënyra më e shpeshtë e raportimit të rasteve të dhunës në familje është potencuar të jetë ajo e raportimit direkt në stacion. Detyrat dhe përgjegjësitë e Policisë lidhur me trajtimin e rasteve të paraqitura si dhunë në familje janë të përcaktuara hollësisht në PSO. Sipas kësaj, Policia duhet t'i përgjigjet secilit njoftim për veprat, kërcënimet e dhunës në familje ose shkeljes së urdhrin për mbrojtje, apo të urdhrin për mbrojtje emergjente, pa marrë parasysh se kush e bën njoftimin.

3.3.2. Policia përpiket që thirrjeve të qytetarëve t'iu përgjigjet në kohë reale, varësisht prioriteteve dhe ngarkesave. Sipas Udhëzuesit për zbatimin e monitorimin e programit të besueshmërisë dhe kënaqshmërisë së publikut, koha e reagimit policor llogaritet duke filluar nga pranimi i informatës nga Qendra Operative Rajonale Komunikuese (QOKK), mbikëqyrësi apo Policia në ndonjërin nga format e komunikimit, koha e dhënies së informatës të patrulla/njësitë që ngarkohet, koha e nisjes së patrullës/njësitit të ngarkuar dhe arritja në vendngjarje. Koha mesatare e reagimit në vendngjarje për zonën urbane është llogaritur të jetë max 15 min, ndërsa për zonën rurale max 30 min, varësisht nga lokacioni ku ndodhë rasti, me përjashtime eventuale në disa zona të thella malore dhe në kushte të papërshtatshme atmosferike⁵. PSO - Koha e reagimit policor përcakton evidentimin e informatave lidhur me ngjarjet në log ditor⁶. Sikur në të gjitha rastet e raportuara në Polici, edhe në ato të dhunës në familje, njësitë e para policore që iu përgjigjen rasteve dhe që shkojnë në vendngjarje janë njësitë patrulluese të stacioneve. Bazuar në raportet fillestare të incidenteve për vitet 2020/2021, është nxjerrë koha mesatare e reagimit për 111 raste⁷, bazuar në informatat mbi kohën e raportimit dhe arritjes në vendngjarje. Nga matjet e bëra në rastet e raportuara në nivel të të gjitha stacioneve, koha mesatare e reagimit të njësisive në rastet e dhunës në familje, del të jetë rreth 13.5 minuta. Kjo

⁴ Sipas kësaj dispozite, Policia e Kosovës përdorë mjete të arsyeshme për të mbrojtur viktimën dhe për të parandaluar dhunën, përfshirë mes tjerash dhe sigurimin e linjës së posaçme telefonike për raportim të dhunës në familje.


⁵ Departamenti për Operacione, *PSO - Koha e reagimit policor*, ref. DDO-04/085/2018, datë 07.09.2018.

⁶ Logu ditor është pasqyrë e krijuar elektronike apo me shkrim, në të cilin duhet evidentuar informimet telefonike zyrtare të pranuar nga cilido informues të mundshëm për një rast apo ngjarje e caktuar të ndodhur më parë apo që është në zhvillim e sipër dhe po ashtu në log evidentohen edhe të gjitha informatat e pranuar në mënyra tjera të informimit për të cilat vlerësohen nëse janë të rëndësishme së veçantë.

⁷ Mostrat janë marrë në stacionet në kuadër të: DRP - Prishtinë (29 matje), DRP - Gjilan (14), DRP - Gjakovë (7), DRP - Prizren (12), DRP - Pejë (13), DRP - Ferizaj, (14), DRP - Mitrovicë Jugu (11) dhe DRP - Mitrovicë Veriu (11).

kohë konsiderohet të jetë brenda limiteve, duke u llogaritur me më pak se 15 minuta. Pesë (5) nga tetë (8) drejtori rajonale (Pejë, Gjakovë, Mitrovicë Jugu, Prishtinë dhe Ferizaj) kanë pasur reagim më të shpejtë të njësive të stacioneve policore në vendngjarje. Drejtoritë tjera rajonale kanë pasur një kohë reagimi paksa më të gjatë edhe pse brenda limiteve, përshkak se stacionet në kuadër të tyre kanë pasur raste kur kanë reaguuar edhe në zona më të thella, ku reagimi deri në 30 minuta konsiderohet i arsyeshëm (duhet përmendur këtu shtrirjen gjeografike të komunave të Dragashit, Novobërdës, Gjilanit dhe Leposaviqit, ku për shkak të konfiguracionit gjeografik dhe hapësirës territoriale që kanë, reagimi policor mund të jetë paksa më i shtyrë (vonuar). IPK çmon angazhimet në reagimin policor, në përgjigje të thirrjeve të viktimave apo dëshmitarëve të dhunës në familje, duke nxitur që në të ardhmen ky reagim të jetë në kohën e nevojshme.

Diagrami 5 - Pasqyrë mbi matjet e reagimit policor në vendngjarje



3.3.3. Rastet e dhunës në familje kërkojnë reagim të shpejtë dhe vigjilencë policore, meqë nga kjo varet edhe mënjanimi apo zvogëlimi i pasojave që mund të rrjedhin nga ushtrimi i dhunës eventuale. Nëse ekziston dyshimi i arsyeshëm se është kryer vepra që ka të bëjë me dhunën në familje, Policia ndalon të dyshimtin. Në nivel të përgjithshëm, IPK-ja ka nxjerrë disa indikatorë që tregojnë se në vitin 2020, varësisht vlerësimeve mbi rrezikun për reagim, Policia ka arrestuar të dyshimtit e përfshirë në dhunë në familje në 44.2% të rasteve të raportuara. Shikuar sipas dhënave të drejtorive rajonale, Gjakovë dhe Mitrovicë - Veriu kanë pasur numër më të madh të të arrestuarve në raport me numrin e rasteve (Gjakova ka më shumë se 1 të arrestuar për rast, kurse Mitrovicë - Veriu ka arrestuar të dyshimtit në 94% të rasteve), derisa Prizreni e Ferizaj kanë pasur shkallë më të ulët të të arrestuarve në raport me numrin e rasteve (7.1%, përkatësisht 19.9% të rasteve). Situata qëndron afërsisht e njëjtë nëse i hedhim sy katër viteve të fundit, ku shihet se reagim më rigoroz policor kanë pasur Gjakova, Mitrovicë - Veriu dhe Mitrovicë - Jugu, të cilat kanë arrestuar të dyshimtit në 99.2%, 57.6% dhe 55.1% të rasteve të raportuara, e që paraqet nivele mbi mesataren e nxjerrur në nivel të të gjitha drejtorive që arrinë në 44.1%. Bazuar në mesataren e përgjithshme të reagimit për katër vitet e fundit, del se pesë drejtoritë tjera kanë një shkallë më të ulët të të arrestuarve në raport me numrin e rasteve (Ferizaj me 17%, Prizreni me 23.8%, Peja me 26.1%, Prishtina me 31.7% dhe Gjilani me 32.3% të rasteve). IPK-ja vlerëson se Policia duhet të trajtoj me kujdes reagimin policor për rastet e dhunës në familje, meqë të dhënat statistikore lidhur me numrin e të arrestuarve tregojnë një divergjencë të theksuar ndërmjet drejtorive regjionale në numra të të arrestuarve në raport me numrin e rasteve të raportuara. Analizat e tilla duhet studiojnë nivelin e rigorizimit gjithmonë duke pasur parasysh vlerësimin e riskut. Njësitë policore, patrulluese a hetimore, duhet të sigurohen që shkalla e rigorizimit korrespondon me shkallën e riskut.

3.3.4. Legjislacioni në fuqi dhe procedurat standarde kanë përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë e mekanizmave institucional, ku ndër tjera përcakton që “Mbrojtësit e viktimave zakonisht takohen me viktimat menjëherë pas reagimit të Policisë ndaj një rasti të lajmëruar të dhunës në familje. Ky kontakt në fillim me viktimën lejon që Mbrojtësi i Viktimave të ndërtojë raport me viktimën që zgjatë gjatë kontaktit të viktimës me mekanizma tjerë institucional. Përgjegjësia e Mbrojtësit të Viktimës është të sigurojë se viktimia kupton shërbimet që mund t’i ofrohen nga shteti dhe si mund t’i pranojë ato. Mbrojtja dhe përkujdesja për viktimat bie në kompetencë të Mbrojtësit të Viktimave. Bazuar në raportet vjetore të katër viteve të fundit, jo gjithëherë kontaktohet Mbrojtësi i Viktimave nga njësitë përgjegjëse. Në nivel të përgjithshëm, IPK-ja ka nxjerrë disa indikatorë që tregojnë se në vitin 2020, Mbrojtësit e Viktimave janë kontaktuar në 65.5% të rasteve. DRP - të në Gjilan, Pejë dhe Ferizaj kanë kontaktuar Mbrojtësit e Viktimave në 99.5%, 95.1% dhe 89.3% të rasteve të raportuara, derisa DRP-të në Mitrovicë Veriu, Prishtinë e Mitrovicë Jugu këtë e kanë bërë në 38.8%, 38.9% dhe 49.3% të rasteve. Situata qëndron më ndryshe nëse i hedhim sy katër viteve të fundit, ku shihet se performancë më të kënaqshme kanë pasur DRP - të në Pejë, Ferizaj, Gjilan dhe Mitrovicë Jugu, të cilat kanë kontaktuar Mbrojtësit e Viktimave në 98.1%, 86.8%, 79.3% dhe 73.1% të rasteve të raportuara, derisa DRP - Prishtinë këtë e ka bërë në 28% të rasteve të raportuara. IPK nuk është e kënaqur me performancën policore në kontaktimin e Mbrojtësve të Viktimave, si një parakusht në ofrimin e shërbimeve më cilësore për viktimat.

Tab. 2 - Indikatorët e performancës së njërive hetimore në trajtimin e rasteve të dhunës në familje (arrestimet dhe kontakti me Mbrojtësit e Viktimave)

Viti	Aktiviteti policor	Drejtoria Rajonale								Total
		Pr	Gjl	Fe	Gjk	Pe	Pz	MJ	MV	
2017	Numri i rasteve	298	169	136	103	211	242	73	37	1.269
	Të arrestuar	90	40	9	105	37	69	43	7	400
	%	30.2	23.7	6.6	98.1	17.5	28.5	58.9	18.9	31.5
	Njoftimi i MV-së	61	57	107	42	206	130	64	27	694
	%	36.1	33.7	78.7	40.8	97.6	53.7	87.7	73.0	54.7
2018	Numri i rasteve	434	211	178	133	188	251	87	51	1.533
	Të arrestuar	107	80	23	115	23	65	52	34	499
	%	24.7	37.9	12.9	86.5	12.2	25.9	59.8	66.7	32.6
	Njoftimi i MV-së	29	184	141	73	188	163	70	32	880
	%	6.7	87.2	79.2	54.9	100	64.9	80.5	62.8	57.4
2019	Numri i rasteve	594	209	204	210	249	286	107	55	1.914
	Të arrestuar	186	64	58	216	88	96	52	28	788
	%	31.3	30.6	28.4	102.9	35.3	33.6	48.6	50.9	41.2
	Njoftimi i MV-së	180	202	204	197	248	132	80	30	1.273
	%	30.3	96.7	100	93.8	99.6	46.2	74.8	54.6	66.5
2020	Numri i rasteve	674	213	206	239	264	266	140	67	2.069
	Të arrestuar	273	79	41	261	104	19	74	63	914
	%	40.5	37.1	19.9	109.2	39.4	7.1	52.9	94.0	44.2
	Njoftimi i MV-së	262	212	184	159	251	192	69	26	1.355
	%	38.9	99.5	89.3	66.5	95.1	72.1	49.3	38.8	65.5
2017/2020	Të arrestuar (%)	31.7	32.3	17.0	99.2	26.1	23.8	55.1	57.6	44.1
	MV të ftuar (%)	28.0	79.3	86.8	64.0	98.1	59.2	73.1	57.3	65.5

Rekomandimi nr. 4

IPK-ja u rekomandon komandantëve të stacioneve policore dhe mbikëqyrësve të ekipeve të hetimeve, që të ushtrojnë kontroll të shtuar mbi njësitë dhe hetuesit që trajtojnë rastet e dhunës në familje, për t'u siguruar se Mbrojtësit e Viktimave njoftohen lidhur me rastet, për të qenë në funksion të viktimave të dhunës në familje.

3.3.5. Në rastet e dhunës në familje, “Policia përdorë mjete të arsyeshme për të mbrojtur viktimën dhe për të parandaluar dhunën, përfshirë, por duke mos u kufizuar vetëm në: vlerësimin e hershëm të rrezikut; hartimin e formës bazike për vlerësimin; sigurimin e kësaj forme edhe akterëve tjerë në procedurë”⁸. Policia sipas PSO-së është e obliguar që në të gjitha rastet e kësaj natyre të plotësoj formën bazike dhe vlerësimin e rrezikut (e cila është e hartuar dhe e gatshme në PSO) dhe t’ia bashkëngjës rasteve konkrete të dhunës në familje. IPK-ja me qëllim që të shihet se sa respektohet ky parim, ka kontrolluar 146 dosje dhe ka gjetur se vetëm 49 prej tyre e kanë të bashkëngjitur këtë formë. Shprehur në përqindje, këta formularë që duhet t’i ketë secila dosje për rastet e dhunës në familje, mungojnë në 66. 5% të tyre. Sidomos këto forma që duhet të jenë në një dosje nuk janë zbatuar në shumicën e rasteve të vitit 2020. Ndërsa, PSO-ja që parasheh këtë formë, është aprovuar në vitin 2013 dhe nga atëherë ka qenë obligative për zbatim nga Policia, por edhe akterët tjerë që merren me rastet e dhunës në familje. Duhet cekur se vlerësimi i rrezikut nga ana e Policisë luan rol me rëndësi në të gjitha rastet kur hetohen si raste të dhunës në familje. Qëllimi i vlerësimit të rrezikut është të ndihmojë në vlerësimin e vuajtjes së vazhdueshme apo dhunës së shtuar ndaj një viktime nga kryesi i dhunës në familje dhe të sigurohen shërbime dhe mbrojtje e duhur.⁹ IPK-ja konsideron se për të përmbushur këtë parim, është e nevojshme që Policia të mbajë trajnime thelbësore që trajtojnë enkas formën bazike, se pse është e rëndësishme kjo formë për palët e përfshira në rastet e dhunës në familje, si të bëhet vlerësimi i rrezikut në këto raste dhe se cilat elemente duhet marrë për bazë gjatë vlerësimit të rrezikut në një rast konkret të dhunës në familje.

Rekomandimi nr. 5

IPK-ja u rekomandon njërive që trajtojnë rastet e dhunës në familje, që të fillojnë së zbatuari në të gjitha rastet e tilla, formën bazike dhe vlerësimin e rrezikshmërisë, siç parashihet me aktet normative në fuqi, duke mos anashkaluar edhe rolin e akterëve tjerë (Mbrojtësin e Viktimave, Qendrën për Punë Sociale, etj).

3.3.6. Gjatë kontrollit të dosjeve është hasur në shumë raste të mospërfshirjes në kuadër të tyre të “Pakove informuese për viktimat e krimit”. Kjo ka filluar të zbatohet nga viti 2019 dhe parashihet Udhëzuesin për zbatimin dhe monitorimin e programit të besueshmërisë dhe kënaqshmërisë së publikut. Pakoja, e cila përmban kartelën e viktimës me informata dhe këshilla mbi rastin, është obligative që nga viti 2020, që të jetë pjesë e rastit dhe dosjes. Gjatë kontrollit të dosjeve të dhunës në familje ka dalë se prej 146 dosjeve, 53 sosh kanë të bashkëngjitur Pakon informuese (36,3% e dosjeve të mostruara kanë përdorur Pakon informuese për viktimën). Edhe këtu duhet të vie në shprehje kontrolli më i rreptë nga menaxherët që secili rast dhe secila viktimë e lidhur me rastin, të pajiset me Pako informuese, ndërsa një kopje të jetë në dosje si dëshmi që palës i është dhënë. Kjo bëhet me qëllim që të gjitha viktimat të informohen për rastin dhe rrjedhën e tij në vazhdimësi.

⁸ Përgjegjësitë e Policisë, fq. 35 - PSV për Mbrojtje nga Dhuna në Familje në Kosovë, Zyra e Kryeministrit - Agjencia për Barazi Gjinore, Prishtinë 2013.

⁹ Vlerësimi i rrezikut nga Policia, fq. 33 - PSV për Mbrojtje nga Dhuna në Familje në Kosovë (Zyra e Kryeministrit - Agjencia për Barazi Gjinore), Prishtinë 2013.

Rekomandimi nr. 6

IPK-ja u rekomandon udhëheqësve të njërive hetimore në kuadër të stacioneve, që të ushtrojnë kontroll të shtuar mbi hetuesit që në rastet e dhunës në familje, viktimat e rastit t'i pajisin me Pako informuese për viktimën, me qëllim të informimit në vazhdimësi për gjendjen e hetimit të rastit, duke u siguruar që një kopje e tyre të mbetet në dosjen e rastit.

3.3.7. Dosja e rastit duhet të ketë mjaftueshëm informata kur të kompletohet. Përveç shumë elementeve që duhet të përmbajë, është edhe foto albumi që duhet të jetë pjesë përbërëse e rasteve konkrete që hetohen nga ana e Policisë. Fotografitë nga vendi i ngjarjes dhe të viktimave tregojnë shumë për rastin, i cili i paraqitet Policisë. Fotografitë pasqyrojnë pretendimet e palëve lidhur me atë se çka ka ndodhur në vendngjarje dhe lëndimet që mund të kenë pasur në rast. IPK-ja ka gjetur se nga 146 raste të kontrolluara, në 81 prej tyre janë bashkëngjitur fotoalbumet e vendit të ngjarjes ose viktimës, ndërsa 65 të tjera nuk kanë fotoalbum (44.5%). Nga këto 65 dosje që nuk kanë fotografi, nga faktet e prezentuara në dosje është gjetur se në 19 raste ka pasur dhunë fizike me lëndime të ndryshme trupore. Kjo gjetje tregon pakujdesi nga ana e Policisë, që në të ardhmen duhet evituar dhe secili rast të kompletohet me foto album për secilën palë të përfshirë në të, me qëllim që të bëhet një hetim sa më profesional, objektiv dhe i paanshëm.

Rekomandimi nr. 7

IPK-ja u rekomandon udhëheqësve të njërive në nivel lokal dhe rajonal, që në të gjitha rastet e dhunës në familje kur dëshmohej se ndaj viktimave është ushtruar dhunë fizike, të sigurojnë fotografi mbi lëndimet dhe të krijojnë fotoalbumin në drejtim të pasurimit të dosjes së rasteve, drejt dëshmimit të dhunës së përdorur për nevoja të procedurës.

3.3.8. Ndër shkaktarët më shpeshtë të rasteve të dhunës në familje, veç faktorëve ekonomik-social, është dhe konsumimi i alkoolit dhe narkotikëve nga kryesit e veprave të tilla. Policia gjatë hetimit të rasteve penale ka të drejtë të përdorë edhe pajisjet për matjen e alkoolit në gjak për një hetim sa më gjithëpërfshirës të rastit konkret. Këtu nuk përjashtohen as hetimet e rasteve të dhunës në familje. Lidhmëria e përdorimit të alkoolit dhe shfaqja e dhunës në familje është vërejtur edhe në rastet konkrete të kontrolluara. Kjo nuk do të thotë që secili rast i dhunës në familje ka qenë si shkak i përdorimit të alkoolit. Mirëpo, IPK-ja duke dashur të dijë se sa Policia aplikon këtë procedurë gjatë procesit hetimor, ka gjetur se nga 146 dosje të mostuara, vetëm në 30 raste është aplikuar matja e prezencës së alkoolit në gjak tek kryesit apo të dyshimtit e dhunës në familje (në 79% të dosjeve të kontrolluara nuk është bërë testimi i tillë)¹⁰. Policia duhet të jetë më e kujdesshme në të gjitha rastet, meqë pretendimet duhet faktuar dhe dokumentuar me dëshmi, ngase kjo do të ndikojë në marrjen e vendimit meritor gjatë procedurës penale të rasteve të dhunës në familje. Kjo imponon situatën që cilësia e hetimit duhet ngritur vazhdimisht.

Rekomandimi nr. 8

IPK-ja rekomandon udhëheqësve të njërive në nivel lokal dhe rajonal që në të gjitha rastet e dhunës në familje kur dyshohet se shkaktari mund të jetë konsumimi i alkoolit, të bëhet testimi i prezencës së alkoolit në gjak tek të dyshimtit dhe rezultati i testimit të mbështetet me dëshmi brenda dosjes, drejt dëshmimit të shkaktarëve të mundshëm që shtyjnë në ndodhjen e dhunës në familje.

¹⁰ Në rastin nr. 2020-GL-584, thuhet se i dyshuari nuk është intervistuar, ngase ka kundërmuar erë alkooli, mirëpo se sa ka qenë përqindja apo vërtetë ka qenë i dehur i dyshuari, nuk është dokumentuar në dosje.

3.3.9. Në aspektin e procedurës penale, “Policia përpilon kallëzim penal, në të cilin paraqiten provat e zbuluara në procesin e mbledhjes së të dhënave dhe dorëzohet së bashku me sendet, skicat, fotografitë, raportet e marra, procesverbalet e masave dhe veprimeve të kryera, shënimet zyrtare, deklaratimet e marra dhe materialet e tjera, të cilat mund të kontribuojnë në zbatimin efektiv të procedurës”¹¹. Kallëzimi penal paraqet aktin pas procesit të hetimit dhe rrethanave që kanë dërguar deri te rasti duke marrë për bazë elementet e cekura më lartë. Një kallëzim i mirë penal bazohet në prova të mbledhura dhe dokumentimin e tyre me fakte, në të kundërtën mund të rezultoj me hedhje të rastit dhe mosndriçim të tij. IPK ka bërë matje se sa njësitë hetimore janë azhure në trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe ka pasur në dispozicion gjithsej 146 mostra të dosjeve hetimore të vitit 2020 dhe 2021 për të matur kohën e procedimit të kallëzimeve penale. Është nxjerrë koha mesatare për të gjitha drejtoritë rajonale dhe ajo e përgjithshme në nivel vendi. Përgjithësisht një kallëzim penal është përgatitur (dorëzuar) për 11 ditë kalendarike, duke marrë në konsideratë periudhën nga momenti i raportimit deri në momentin e procedimit në Prokurorinë kompetente. Nëse krahasojmë performancën e secilës drejtori rajonale veç e veç, vërejmë se njësitë hetimore të DRP Gjilan, Ferizaj dhe Gjakovë kanë qenë më të shpejta në procedimin e kallëzimeve penale duke arritur mesataren prej 3, 7 dhe 8 ditësh për rast. Kurse njësitë të stacioneve policore në kuadër të drejtorive tjera iu është nevojitur kohë më e gjatë për procedimin e rasteve (Mitrovicë Veriu, Mitrovicë Jugu dhe Peja kanë proceduar rastet çdo të 18 ditë). Nga kontrolli i lëndëve të mostruara del se në disa raste, përmbajtja e kallëzimeve shtron nevojën për ngritje të cilësisë të hartimit. Kallëzimet penale duhet të jenë më përmbajtësore në aspektin e dokumentimit të fakteve dhe duhet të mbledhin sa më shumë dëshmi dhe deklaratatë të dëshmitarëve, për të ardhur deri tek konstatimet e sakta. Mbikëqyrësit e hetuesve duhet të ushtrojnë kontrollë më të rreptë të rasteve dhe kallëzimeve, para se ato të procedohen tutje në organet e drejtësisë, në drejtim të ngritjes së kualitetit dhe përmbajtjes së kallëzimeve penale. Duhet synuar që aktivitetet e tilla të mos trajtohen si rutinë.

Tabela 3 - Përmbledhje e të dhënave mbi kohën mesatare të hetimit, kompletimit dhe procedimit të rasteve të dhunës në familje			
Drejtoria rajonale	Numri i mostrave të përzgjedhura	Numri i ditëve në përmbylljen e rasteve	Koha mesatare e dorëzimit të kallëzimeve penale
Prishtinë	32	339	11
Gjilan	22	66	3
Ferizaj	21	148	7
Gjakovë	7	59	8
Pejë	18	227	13
Prizren	16	181	11
Mitrovicë Jugu	14	251	18
Mitrovicë Veriu	16	287	18
Gjithsej	146	1.558	11 ditë

3.3.10. Policia në nivel lokal dhe rajonal duhet që rregullisht të dorëzojë raporte dhe statistika lidhur me rastet e dhunës në familje. Hetuesit e dhunës në familje në çdo rajon janë të obliguar të raportojnë dhe t'i dërgojnë raportet dhe statistikat periodike në Njësinë e Hetimeve të Dhunës në Familje në nivel qendror. Përveç obligimit të cekur më lartë, hetuesit policor kanë obligim ligjor¹²

¹¹ Kodi nr. 04/L-123 i Procedurës Penale.

¹² Ligji nr. 03/L-182 për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, neni 24, paragrafi 4.

që pas përpilimit të raportit lidhur me rastin, një kopje t'i dorëzojnë viktimës, përfaqësuesit të autorizuar dhe mbrojtësit të viktimës. Drejtoria për Policimin në Bashkësi dhe Parandalim - Sektori i dhunës në familje që kryesisht menaxhon me informatat dhe statistikat lidhur me këto raste, ka përpiluar një formular standard të Raportit për raste të tilla, i cili duhet të jetë pjesë e dosjes në rast të veprave penale të dhunës në familje. Këto raporte që duhet t'i dërgohen edhe Drejtorisë në fjalë, janë të dobishme për strukturën përgjegjëse, ngase nëpërmjet tyre mundësohet mbikëqyrje më rigoroze dhe efektive në trajtimin e rasteve të dhunës në familje. Në bazë të të dhënave në nivel vendi, gjatë vitit 2020, nga 2.069 raste të raportuara, në 86% të tyre, njësitë kompetente policore për trajtimin e rasteve të dhunës në familje kanë arritur të dërgojnë raporte në adresë të nivelit qendror. Gjatë periudhës janar - qershor 2021, ky numër ka shënuar një ngritje krahasuar me vitin paraprak, ngase nga gjithsej 1.124 raste të raportuara, në 91% të tyre njësitë policore kanë arritur të dërgojnë raporte ditore. Nga informatat e marra nga Udhëheqësi i Sektorit për Dhunë në Familje në kuadër të Drejtorisë së Policimit në Bashkësi dhe Parandalim, në vitet paraprake ka pasur ngecie në drejtim të përmbushjes së këtij obligimi. Moshartimi i raporteve për të gjitha rastet e raportuara, sipas Policisë ka ardhur përshkak se që nga viti 2020, Policia ka qenë e angazhuar në kuadër të planeve për zbatimin e masave Anti-Covid. Në anën tjetër, nga kontrolli i 146 dosjeve të rasteve të dhunës në familje, del se 40 prej tyre kanë pasur raportin në fjalë. Ky raport duhet të jetë patjetër pjesë e dosjes së rastit.

Tabela nr. 4 - Të dhëna mbi numrin e rasteve të raportuara të dhunës në familje dhe raporteve ditore gjatë vitit 2020 dhe gjashtëmujorit të parë 2021						
Drejtoria rajonale	2020			Janar-Qershor 2021		
	Numri i rasteve	Numri i raporteve	%	Numri i rasteve	Numri i raporteve	%
Prishtinë	674	586	87.0	366	350	95.6
Gjilan	213	195	91.5	119	108	90.7
Gjakovë	239	203	85.0	129	118	91.4
Prizren	266	231	86.8	161	147	91.3
Pejë	264	237	89.7	137	128	93.4
Ferizaj	206	165	80.1	110	80	72.7
Mitrovicë J.	140	118	84.2	77	73	94.8
Mitrovicë V.	67	50	74.6	25	18	72.0
Total	2.069	1.785	86.2%	1.124	1.022	91.0 %

Rekomandimi nr. 9

IPK-ja u rekomandon udhëheqësve të njësisve në nivel lokal dhe rajonal, që në të gjitha rastet kur ka dhunë në familje, të përpilohet raport lidhur me rastin, pavarësisht a është kryer vepra apo jo, dhe një kopje të këtij raporti t'i dërgohet Koordinatorit për dhunën në familje në nivel qendror.

3.3.11. IPK-ja është interesuar të dijë nëse kryesit e dhunës në familje në këto raste janë persona me të kaluar kriminale dhe sa është përfillur ky element për të dokumentuar në dosje të kaluarën e tyre kriminale. Në këtë drejtim, Policia ka bërë punë të mirë dhe shumicës së dosjeve të kontrolluar iu janë bashkangjitur dëshmitë mbi të kaluarën kriminale të kryesve të dhunës në familje. IPK-ja inkurajon Policinë që edhe më tutje të sigurojë të dhënat për të kaluarën kriminale, të secilit person të dyshuar, ngase kjo do të ndihmojë organet gjyqësore kur të marrin vendime mbi rastet konkrete.

3.3.12. Meqenëse Policia është organi kompetent për ekzekutimin e masave mbrojtëse¹³, fokus i këtij inspektimi ka qenë vlerësimi i aktivitetit të Policisë në mbikëqyrjen dhe zbatimin e masave mbrojtëse për viktimat e dhunës në familje. Stacioneve policore u është kërkuar informacion lidhur me atë nëse zyrtarët policor realizojnë “vizita” tek viktimat me qëllim të mbikëqyrjes së zbatimit të urdhrave mbrojtës. Sipas drejtuesve policor, sa herë ka urdhër mbrojtës nga Gjykata, viktimat kontaktohen nga hetuesit primar apo sekondar të ngarkuar me trajtimin e rastit, si dhe viktimave iu lihen në dispozicion numrat kontaktues të hetuesve primar, në mënyrë që të kontaktojnë me ta sa herë që kanë nevojë. Kurse, sa i përket vizitave të vazhdueshme në shtëpi tek viktimat, të gjeturat tregojnë se ka ngecie në këtë drejtim. Në stacionet policore më të mëdha, për shkak të numrit të pamjaftueshëm të zyrtarëve policor, është e pamundur të realizohen vizita të vazhdueshme për viktimat e dhunës për të cilat ka urdhër mbrojtës. Kurse në disa stacione policore ku deklarohen se realizojnë vizita të kësaj natyre, nuk është hasur në formularë që argumentojnë prezencën policore në vizita te viktimat e dhunës në familje. Policia duhet të shtojë aktivitetet duke angazhuar personel për mbikëqyrje të vazhdueshme e efektive për zbatimin e urdhrave mbrojtës për viktimat e dhunës.

Rekomandimi nr. 10

IPK-ja u rekomandon drejtorive rajonale dhe stacioneve policore që të gjejnë alternativa për angazhim të njësisve policore për mbikëqyrje të vazhdueshme të zbatimit të urdhrave mbrojtës të viktimave të dhunës në familje. Krahas këtyre aktiviteteve, njësitë policore të argumentojnë prezencën fizike duke aplikuar mbajtjen e evidencave, që do të nënshkruhen nga viktimat dhe zyrtarët policor që realizojnë vizitat.

3.3.13. IPK-ja është njohur me performancën e njësisve të stacioneve dhe drejtorive rajonale mbi hetimin, kompletimin dhe procedimin e lëndëve në Prokurori. Në vitin 2020, mesatarisht në nivel të të gjitha drejtorive rajonale, 92.6% e rasteve janë proceduar brenda vitit në Prokurori, derisa 7.4% e rasteve kanë mbetur për hetim dhe janë bartur në vitin pasues. DRP - Ferizaj dhe Mitrovicë Jugu brenda vitit 2020 kanë arritur të procedojnë 100% të rasteve të trajtuara. Marrë parasysh katër vitet e fundit, është nxjerrë një mesatare e përgjithshme në nivel vendi, sipas së cilës, 94% e rasteve janë proceduar brenda viteve përkatëse. DRP - Pejë dhe Ferizaj rezultojnë me performancë më të mirë në procedimin e rasteve të dhunës në familje. DRP - Mitrovicë Jugu me gjithë faktin se dy vitet e fundit ka pasur një performancë të mirë, marrë parasysh mesataren për katër vitet e fundit, kjo performancë del të jetë me e ulët përshkak se në vitet 2017 dhe 2018, ka pasur një përqindje të ulët të procedimit të rasteve. Marrë parasysh informacionet e drejtorive, IPK vlerëson se trendët e viteve të fundit tregojnë se kemi një performancë të lartë në procedimin e rasteve dhe se numri i lëndëve të bartura është i vogël. IPK inkurajon njësitë që merren me hetimin e rasteve të dhunës në familje që të vazhdojnë në përmbylljen në kohë të rasteve të raportuara dhe të trajtuara.

Viti	Pr	Gjl	Fe	Gjk	Pe	Pz	MJ	MV	Totali
2017	98.3	98.8	99.3	100	100	96.7	42.5	94.6	95.3
2018	98.4	96.2	100	96.8	99.8	91.6	38.0	98.1	93.7
2019	94.3	97.1	99.0	95.3	100	79.7	100	100	94.3
2020	87.1	89.2	100	92.5	98.9	92.9	100	94.0	92.6
Mesatare 2017-2020	94.5%	95.3%	99.6%	96.2%	99.7%	90.2%	70.1%	96.7%	94.0%

¹³ Ligji nr. 03/L-182 për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, neni 3, paragrafi 6.

3.3.14. IPK ka qenë e interesuar të analizojë edhe të dhënat statistikore mbi numrin e të ndaluarve, por se kjo është vështirësuar, meqë raportet e viteve paraprake nuk përmbajnë informacion mbi numrin e të ndaluarve, por vetëm të të arrestuarve. Në vitin e fundit vërehet se Policia e Kosovës ka filluar të pasqyrojë dhe numrin të ndaluarve në rastet e dhunës në familje. Në vitin 2020, Policia ka regjistruar gjithsej 303 të ndaluar si rezultat i dyshimeve për përfshirje në dhunë familjare. Ç'është interesante në këto të dhëna, DRP Prishtinë nuk ka asnjë të evidentuar si të ndaluar gjatë vitit 2020. Gjatë kontrollit të dosjeve, inspektorët kanë hasur se në disa prej dosjeve të DRP Prishtinë janë evidente informatat mbi personat e ndaluar, por edhe aktvendimet mbi ndalimin¹⁴. Kjo e gjetur mund të vë në mëdyshje besueshmërinë e informatave të pasqyruara në raportet periodike. Andaj, drejtoritë rajonale, përfshirë dhe stacionet policore duhet të jenë të kujdesshme në raportimin e ngjarjeve, ngase mund të vie deri tek rënia e besueshmërisë së informatave.

Rekomandimi nr. 11

IPK-ja u rekomandon Mbikëqyrësve të Ekipeve për Hetime të Veprave Penale “Dhunë Familjare dhe Delikuencë të të Miturve” dhe Udhëheqësve të Ekipeve të hetimit të dhunës në familje në kuadër të stacioneve policore, që të sigurohen se informacionet e pasqyruara në raporte periodike të jenë të plota dhe të sakta sa i përket ngjarjeve që lidhen me dhunën në familje, në mënyrë që ato të jenë të bazuara dhe të besueshme.

¹⁴ Sa për ilustrim janë hasur disa nga rastet me nr. 2020-AF-1131, 2020-AC-0955, 2020-AC-0502, 2020-AS-73, 2020-AF-0473, 2020-AF-0231, 2020-AJ-0086, 2020-AJ-0229, 2020-AH-0121, 2020-AT-0311.

4. Plani i përmbushjes së rekomandimeve

4.1. Plani për përmbushjen e rekomandimeve

4.1.1. Mbi bazën e gjetjeve, IPK ka dhënë një numër rekomandimesh dhe pas komenteve të ofruara nga menaxhmenti policor në takimin përmbysllës të datës 13.10.2021, është vendosur që ato të realizohen sipas Planit të Veprimit të prezantuar në tabelën e mëposhtme.

Nr.	Rekomandimi	Niveli i prioritetit	Komentet e strukturës policore (në origjinal)	Plani i veprimit
1.	IPK-ja përseri i rekomandon Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë që të shtyjë para procesin e finalizimit për ndryshimin e Procedurës Standarde të Veprimit - Hetimi i Dhunës Familjare (PK/SHH-PSO 1.17), më qëllim harmonizimi të plotë me Ligjin nr. 03/L-182 për Mbrojtje nga Dhuna në Familje.	-II-	Rekomandimi qëndron. Është hartuar draft Procedura Standarde e Veprimit „Hetimi i dhunës familjare, por që jemi në pritje të plotësim – ndryshimit të ligjit të ri për mbrojtje nga dhuna në familje, ku Drejtoria e Policisë në Bashkësi dhe Parandalim, konkretisht sektori i dhunës në familje është pjesë e grupit punues në nivel Qeveritar për modifikim të këtij ligji dhe posa të aprovohet ky ligj, atëherë Procedura Standarde e Veprimit do të harmonizohet me ligjin e ri dhe do të jetë e gatshme për implementim.	
2.	IPK-ja i rekomandon Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë dhe Drejtorit të Departamentit për Shërbime Mbeshtetëse, që në të ardhmen brenda mundësive buxhetore, të planifikojnë dhe realizojnë ndarjen dhe funksionalizimin e ambienteve të veçanta si “dhoma mike”, si praktika të mira të aplikuara në vendet e zhvilluara, për trajtimin e viktimave të dhunës në familje.	-II-	Rekomandimi qëndron. Momentalisht në Policinë e Kosovës janë 17 dhoma mike funksionale. Duke ditur që është e nevojshme të shtohet numri i krijimit të këtyre dhomave, Policia në bashkëpunim me OSBE-në dhe KFOR-in Italian (Karabinierët), është në proces të funksionalizimit edhe të pesë (5) dhomave mike duke qar numrin në 22 dhoma mike funksionale, por që në të ardhmen synohet të shtohet edhe më tej numri i këtyre dhomave. Po ashtu, edhe sektori i dhunës në familje pran Drejtorisë së Policisë në Bashkësi dhe Preventivë ka një projekt për furnizim me pajisje shtesë të dhomave mike në 10 Stacione policore me qëllim të përmirësimit të ambientit rreth	Dhjetor 2021, në vazhdimësi,

			funksionimit sa më të mirë të këtyre dhomave.	
3.	IPK-ja i rekomandon Udhëheqësit të Divizionit të Trajnimeve dhe Drejtorëve Rajonal që në të ardhmen, brenda programeve trajnuese nga fusha e dhunës familjare, të përfshihet dhe personeli policor i njësisve patrulluese (reaguese, sektoriale), me synimin që njësitë e tilla të kenë njohuritë e duhura për të reaguar në rastet e dhunës në familje.	-II-	Rekomandimi qëndron pjesërisht. Trajnimet nga fusha e dhunës në familje veç se mbahen në vazhdimësi, ku gjatë këtij vit janë realizuar trajnime një ditore në të gjitha stacionet me temë „Trajtimi i rasteve të dhunës në familje”. Drejtoria e Policisë në Bashkësi dhe Parandalim- sektori i dhunës në familje në bashkëpunim me Agjencinë për Barazi gjinore nga Qeveria e Republikës së Kosovës ka filluar projektin e trajnimeve dy ditore në të (8) Rajonet e Kosovës me temën „Trajtimi i rasteve të dhunës në familje”. Deri më tani janë mbajtur 5 punëtori dhe janë trajnuar 133 polic reagues/ patrullues. Gjatë këtij viti do të mbahen edhe 3 punëtori tjera. Ky aktivitet është planifikuar që të vazhdohet edhe gjatë vitit 2022.	2021, në vazhdimësi
4.	IPK-ja u rekomandon komandantëve të stacioneve policore dhe mbikëqyrësve të ekipeve të hetimeve, që të ushtrojnë kontroll të shtuar mbi njësitë dhe hetuesit që trajtojnë rastet e dhunës në familje, për t'u siguruar se Mbrojtësit e Viktimave njoftohen lidhur me rastet, për të qenë në funksion të viktimave të dhunës në familje.	-I-	Rekomandimi qëndron. Do të sigurohemi që mbikëqyrësit ta monitorojnë çdo raste të dhunës në familje me qëllim që të informohet mbrojtësi i viktimave dhe të evidentohen me shkrim se njoftimi është bërë nga ana zyrtareve policor hetues si dhe të evidentojnë edhe nëse mbrojtësi i viktimave nuk është prezent në rastin e thirrur.	Menjëherë
5.	IPK-ja u rekomandon njësisve që trajtojnë rastet e dhunës në familje, që të fillojnë së zbatuari në të gjitha rastet e tilla, formën bazike dhe vlerësimin e rrezikshmërisë, siç parashihet me aktet normative në fuqi, duke mos anashkaluar edhe rolin e akterëve tjerë (Mbrojtësin e Viktimave, Qendrën për Punë Sociale, etj).	-I-	Rekomandimi qëndron. Drejtoria e Policisë në Bashkësi dhe Parandalim, përkatësisht sektori i dhunës në familje përmes strukturës komanduese, në vazhdimësi do të kërkoj nga zyrtaret policor- hetues të nivelit lokal që të zbatohet në tërësi plotësimi i formave bazike sipas Procedurës Standarde të Veprimt, procedurë kjo	Menjëherë

			<i>miratuar nga niveli Qeveritar i Republikës së Kosovës. Do të monitorohet nga niveli qendror, rajonal dhe tek mbikëqyrësit e njësive policore që domosdoshmërisht të aplikohet në çdo rast vlerësimi i rrezikut sipas formës së paraparë.</i>	
6.	<i>IPK-ja u rekomandon udhëheqësve të njësive hetimore në kuadër të stacioneve, që të ushtrojnë kontroll të shtuar mbi hetuesit që në rastet e dhunës në familje, viktimat e rastit t'i pajisin me Pako informuese për viktimën, me qëllim të informimit në vazhdimësi për gjendjen e hetimit të rastit, duke u siguruar që një kopje e tyre të mbetet në dosjen e rastit.</i>	<i>-I-</i>	<i>Rekomandimi qëndron pjesërisht. Përkundër që pakoja informuese do të duhej aplikuar në të gjitha rastet sipas procedurës dhe do të vazhdoj të aplikohet kështu çdo herë bazuar në Procedurën Standard të Veprimit, Niveli qendror i PK-së do të monitoroj këtë proces..</i>	<i>Menjëherë</i>
7.	<i>IPK-ja u rekomandon udhëheqësve të njësive në nivel lokal dhe rajonal, që në të gjitha rastet e dhunës në familje kur dëshkohet se ndaj viktimave është ushtruar dhunë fizike, të sigurojnë fotografi mbi lëndimet dhe të krijojnë fotoalbumin në drejtim të pasurimit të dosjes së rasteve, drejt dëshimit të dhunës së përdorur për nevoja të procedurës.</i>	<i>-I-</i>	<i>Rekomandimi qëndron. Niveli qendror dhe lokal do të monitoron të gjitha rastet e dhunës në familje, në veçanti tek viktimat që kanë lëndime fizike dhe ato të dokumentohen në të gjitha rastet në dosjet e tyre.</i>	<i>Menjëherë</i>
8.	<i>IPK-ja rekomandon udhëheqësve të njësive në nivel lokal dhe rajonal që në të gjitha rastet e dhunës në familje kur dyshohet se shkaktari mund të jetë konsumimi i alkoolit, të bëhet testimi i prezencës së alkoolit në gjak tek të dyshimtit dhe rezultati i testimit të mbështetet me dëshmi brenda dosjes, drejt dëshimit të shkaktarëve të mundshëm që shtyjnë në ndodhjen e dhunës në familje.</i>	<i>-I-</i>	<i>Rekomandimi qëndron. Policia është duke bërë përpjekje që të siguroj alkool testet nga njësitet tjera me qëllim që sektori qendror i dhunës në familje t'i pajis secilin stacion policor dhe Hetimet rajonale së paku një alkool testit për hetimin e rasteve të DHF.</i>	<i>Dhjetor 2021 dhe vazhdimësi</i>
9.	<i>IPK-ja u rekomandon udhëheqësve të njësive në nivel lokal dhe rajonal, që në të gjitha rastet kur ka dhunë në familje, të përpilohet raport lidhur me rastin, pavarësisht a është kryer vepra apo jo, dhe një kopje të këtij raporti t'i dërgohet Koordinatorit për dhunën në familje në nivel qendror.</i>	<i>-I-</i>	<i>Rekomandimi qëndron pjesërisht. Raportet ditore janë duke u aplikuar në shumicën e rasteve, mirëpo ne do të monitorojmë edhe me tutje dhe mbikëqyrim procesin e raportimit siç kërkohet me PSO;</i>	<i>Vazhdimisht</i>
10.	<i>IPK-ja u rekomandon drejtorive rajonale dhe stacioneve policore që</i>	<i>-I-</i>	<i>Rekomandimi qëndron. Drejtoria e Policisë në Bashkësi</i>	<i>Dhjetor 2021</i>

	<p>të gjejnë alternativa për angazhim të njësisve policore për mbikëqyrje të vazhdueshme të zbatimit të urdhrave mbrojtës të viktimave të dhunës në familje. Krahas këtyre aktiviteteve, njësitë policore të argumentojnë prezencën fizike duke aplikuar mbajtjen e evidencave, që do të nënshkruhen nga viktimat dhe zyrtarët policor që realizojnë vizitat.</p>		<p>dhe Parandalim do të krijoj një formë unike e cila do të shpërndahet në nivelin lokal me qëllim të implementimit të këtij rekomandimi dhe forma të mbetet në dosje të lëndës.</p>	<p>Dhe në vazhdimësi</p>
11.	<p>IPK-ja u rekomandon Mbikëqyrësve të Ekipeve për Hetime të Veprave Penale “Dhunë Familjare dhe Delikuencë të të Miturve” dhe Udhëheqësve të Ekipeve të hetimit të dhunës në familje në kuadër të stacioneve policore, që të sigurohen se informacionet e pasqyruara në raporte periodike të jenë të plota dhe të sakta sa i përket ngjarjeve që lidhen me dhunën në familje, në mënyrë që ato të jenë të bazuara dhe të besueshme.</p>	-I-	<p>Rekomandimi qëndron. Policia do të monitoron dhe mbikëqyr procesin e raportimit rreth përputhshmërisë dhe saktësisë të statistikave të prezantuara në raporte periodike.</p>	Menjëherë

Shtojca 1: Të dhëna mbi përmbushjen e rekomandimeve nga inspektimet e mëparshme				
Gjetjet nga inspektimi i mëparshëm (viti 2018)				
Inspektimi: Kryerja e detyrave policore gjatë trajtimit të rasteve të dhunës në familje, nr. 6/2018				
Nr.	Rekomandimi i dhënë	Komentet e strukturës policore (në origjinal)	Afatet për zbatim	Niveli i zbatimit
1.	<i>IPK-ja i rekomandon Drejtorit të Departamentit të Hetimeve në kuadër të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë, që të plotësohet ndryshohet Procedura Standarde e Veprimit - Hetimi i Dhunës Familjare (PK/ShH-PSO 1.17), në mënyrë që të jetë në harmoni të plotë me Ligjin nr. 03/L-182 për Mbrojtje nga Dhuna në Familje.</i>	<i>Rekomandimi qëndron. Kemi hartuar draft PSV. Jemi në pritje të plotësim ndryshimit të KPK-së, ku do t'i fusim inputet me ndryshime të Kodit Penal. Pasi që Sektori për Hetimin e Dhunës në Familje ka kaluar në Departamentin e Operacioneve, kjo PSV do të miratohet nga Drejtori i Departamentit të Operacioneve. Kjo PSV hartohet nga Sektori dhe aprovohet nga Drejtori i Operacioneve</i>	<i>Janar 2019</i>	<i>Vlerësimi nga IPK-ja: I pa përmbushur (I iniciuar)</i>
2.	<i>IPK-ja i rekomandon Udhëheqësit të Divizionit të Personelit që në afat sa më të shkurtër kohor të bëjë plotësimin e pozitës Mbikëqyrës i Ekipit për Hetimin e Veprave Penale 'Dhunë Familjare dhe Delikuencë e të Miturve' në Drejtorinë Rajonale Policore të Gjakovës</i>	<i>Rekomandimi qëndron. Është kërkuar nga DRP- Gjakovë, të përzgjedhë dhe të caktojë në detyrë-Mbikëqyrësin e Hetimeve të veprave penale të dhunës në familje në DRP në Gjakovë. E realizon Drejtori Rajonal në DRP, Gjakovë</i>	<i>Mars 2019</i>	<i>Vlerësimi nga IPK-ja: Plotësisht</i>
3.	<i>IPK-ja i rekomandon Udhëheqësit të Divizionit të Personelit që të bëjë harmonizimin e Listës së Personelit të Autorizuar me Procedurën Standarde të Veprimit - Hetimi i dhunës familjare (PK/ShH-PSO 1.17), duke përfshirë caktimin e pozitave konkrete për hetuesit e dhunës në familje si në nivelin regional, poashtu edhe në nivelin e stacioneve policore</i>	<i>Rekomandimi qëndron. Jemi në procedurë të ndryshimit të strukturës organizative të Policisë së Kosovës dhe këto rekomandime do të reflektohen në strukturë të PK-së. Gjithashtu do të rifreskohen vendimet të caktimit në detyrë për zyrtarët në hetime të dhunës në familje, duke u bazuar në PSV të re dhe në ndryshimet e ligjeve tjera bazike.</i>	<i>Korrik 2019</i>	<i>Vlerësimi nga IPK-ja: Plotësisht</i>
4.	<i>IPK-ja u rekomandon Udhëheqësve të Sektorëve Rajonal të Hetimeve dhe Shefave të Njërive të Hetimeve</i>	<i>Rekomandimi qëndron. Do të ngritet efikasiteti i punës të zyrtarëve policor që hetojnë rastet e dhunës në familje në të</i>	<i>Menjëherë</i>	<i>Vlerësimi nga IPK-ja: Plotësisht</i>

	<p><i>në stacione policore, që të rrisin edhe më shumë efikasitetin në zgjidhjen e rasteve të dhunës në familje, duke marrë parasysh ndjeshmërinë dhe trendin në ngritje të tyre</i></p>	<p><i>gjitha stacionet policore e posaçërisht në DRP- Mitrovicë Jugu dhe Veriu. Zbatimi i rekomandimeve do të bëhet nga udhëheqësit në DRP dhe në stacionet policore në përkrahjen dhe monitorimin nga Sektori për parandalimin e Dhunës në Familje në Drejtorinë e Policisë në Bashkësi dhe Preventivë.</i></p>		
--	--	--	--	--

Shtojca 2

Indikatorët	Prishtinë	Gjilan	Ferizaj	Gjakovë	Pejë	Prizren	Mitro. Jugu	Mitro. Veriu	Totali
Popullsia	485.368	166.935	183.250	206.200	227.748	290.143	183.238	39.234	1.782.115
Pjesëmarrja numrit të banorëve (regjioneve) në strukturën e përgjithshme të popullësisë	27.2%	9.4%	10.3%	11.6%	12.8%	16.3%	10.3%	2.2%	100%
Raste (2017)	298	169	136	103	211	242	73	37	1.269
Raste (2018)	434	211	178	133	188	251	87	51	1.533
Pjesëmarrja (%)	28.3	13.8	11.6	8.7	12.3	16.4	5.7	3.3	100
Në 1.000 banorë	0.89	1.26	0.97	0.65	0.83	0.87	0.47	1.30	0.86
Trendi	+45.6	+19.9	+30.9	+29.1	-10.9	+3.7	+19.2	+37.8	+20.8
Raste (2019)	594	209	204	210	249	286	107	55	1.914
Pjesëmarrja	31.0	10.9	10.7	11.0	13.0	15.0	5.6	2.9	100
Në 1.000 banorë	1.22	1.25	1.11	1.02	1.09	0.99	0.58	1.40	1.07
Trendi	+36.9	-1.0	+14.6	+57.9	+32.4	+13.9	+23.0	+7.8	+24.9
Raste (2020)	674	213	206	239	264	266	140	67	2.069
Pjesëmarrja	32.6	10.3	10.0	11.6	12.7	12.8	6.8	3.2	100
Në 1.000 banorë	1.39	1.28	1.12	1.16	1.16	0.92	0.76	1.71	1.16
Trendi	+13.5	+1.9	+1.0	+13.8	+6.0	-7.0	+30.8	+21.8	+8.1